

Departamenti për Demokratizim  
Sektori për Pjesëmarrje Publike

Prishtinë, 04/06/2021

**Thirrje e hapur  
për**

**Tridhjetë (30) kandidatë për programin tre-mujor të punës praktike**

Informata të përgjithshme

Pjesëmarrja publike e të rinjve në vendimmarrje garantohet dhe promovohet përmes një kornize gjithëpërfshirëse normative dhe të politikave që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në Kosovë. Kjo kornizë përfshin Ligjin për "Fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë"; katër udhëzime administrative (UA); dhe Strategjinë për Rininë që përcakton prioritetet dhe qëllimet për periudhën 2019-2023.

Të rinjtë kanë të drejta dhe mundësi për të ndikuar në vendimmarrje dhe politikëbërje, qoftë drejtpërdrejt ose përmes organeve ekzistuese përfaqësuese dhe organizatave të shoqërisë civile.

Sidoqoftë, rinia shpesh nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e saj dhe të përmbushë përgjegjësitë e saj në lidhje me përfshirjen në vendimmarrje. Arsyet janë të dyfishta: nga njëra anë, të rinjtë mund të kenë mungesë të vetëdijes, aftësive, njohurive, aftësive teknike dhe përvojës së kërkuar; nga ana tjetër, mundësitë e ofruara nga institucionet në të gjitha nivelet për të përfshirë të rinjtë në vendimmarrje dhe politikëbërje janë të kufizuara. Si rezultat, të rinjtë dekurajohen ose përjashtohen nga ushtrimi i së drejtës për pjesëmarrje dhe izoloohen nga sfera e vendimmarrjes.

OSBE promovon pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes përmes një qasjeje pjesëmarrëse, bazuar në parimin e 'të mësuarit duke bërë' me synim për t'i pajisur të rinjtë me aftësi dhe njohuri adekuate të transferueshme. OSBE-ja do ta mbështesë organizimin e një Programi tre-mujor të praktikës për 30 të rinj mes moshave 20 dhe 24 vjeç, në bashkëpunim me institucione të ndryshme<sup>1</sup>. Qëllimi i programit është përfshirja e drejtpërdrejtë e të rinjve në nivelin strategjik, planifikues dhe ekzekutiv të punës së institucioneve kryesore të vendimmarrjes dhe politikëbërjes dhe njohja e tyre me mandatin e këtij të fundit, fushveprimin e punës, detyrat dhe përgjegjësitë.

Praktikantët do të vendosen në zyra/divizione/departamente të ndryshme brenda institucioneve bashkëpunuese, bazuar në profilin dhe interesimin e tyre por gjithashtu në përputhje me nevojat dhe kapacitetet pritëse të institucioneve përkatëse. Mentorimi i praktikantëve do të kryhet nga stafi i zgjedhur i zyrave/divizioneve/departamenteve brenda institucioneve bashkëpunuese, nën koordinimin e përgjithshëm të ekipit të

---

<sup>1</sup>Siç janë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Komuna e Prishtinës

projektit të Sektorit të Pjesëmarrjes Publike të OSBE-së (PPS). Programi i praktikës do të paraprihet nga një trajnim i hollësishëm fillestar i ofruar bashkërisht nga ekipi i projektit të OSBE-së dhe stafi i institucioneve bashkëpunuese dhe do të përqendrohet por nuk do të kufizohet vetëm në: kornizën ligjore, procesin e konsultimit gjatë hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore, proceset e rishikimit, monitorimin dhe informimin, planifikimin dhe programimin, vlerësimin, hulumtimin dhe hartimin e dokumenteve të politikave, etj. Është paraparë edhe një trajnim në mes të programit diku në mes të tetorit 2021.

Programi i praktikës do të përfundojë me një konferencë, ku praktikantët do të paraqesin atë që kanë mësuar dhe cili ishte kontributi i tyre gjatë turneut në vendet përkatëse të punës.

### Objektivi

OSBE synon të ndihmojë tridhjetë (30) të rinj në të kuptuarit më të mirë dhe përvetësimin e përvojës në vendimmarrje dhe politikëbërje përmes programit tre-mujor të praktikës në institucione të ndryshme.

### Detyrat

Varësisht nga lloji i punës dhe plani i punës së departamenteve/divizioneve/seksioneve të institucioneve bashkëpunuese ku do të vendosen praktikantët, ata mund të ngarkohen, *ndër të tjera*, me këto detyra:

- Asistim në procesin e hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore;
- Asistim të departamenteve/divizioneve/seksioneve në kryerjen e rolit të tyre këshillues dhe ofrim të mendimeve të kërkuara nga institucionet;
- Mbështetje të departamenteve/divizioneve/seksioneve në përgatitjen e inputeve për raportet e jashtme;
- Kontribut në zbatimin e projektit(eve) të cilat departamentet/divizionet/seksionet i drejtojnë ose në të cilat kontribuojnë (planifikimi/zhvillimi/implementimi dhe/ose vlerësimi);
- Asistim në koordinimin dhe bashkëpunimin me donatorët dhe partnerët aktualë dhe potencialë;
- Kontribut në proceset e rregullta të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm;
- Sigurim i informatave kthyesë për propozimet e politikave përmes koncept dokumenteve dhe pjesëmarrës në takimet përkatëse;
- Përgatitje e materialit bazë për takimet e brendshme dhe të jashtme, pjesëmarrje në takime dhe përpilim i procesverbaleve;
- Kryerje e hulumtimeve dhe analizave të programeve të departamenteve/divizioneve/seksioneve;
- Dizajnim i propozimit të orarit të rregullt të komunikimit me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit;
- Kryerje e detyrave të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi/koordinatori i programit.
- Pjesëmarrje në hartimin e dokumentit të përbashkët kërkimor, që do të bëhet nga të gjithë praktikantët duke kontribuar në zhvillimin e një drafti përfundimtar deri në fund të nëntorit të vitit 2021.

### Rezultatat e pritshme:

- Plani i punës me skicë të detajuar të detyrave dhe përgjegjësi (e bashkë-përgatitur me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit);
- Projektligjet; rregulloret; udhëzimet administrative në të cilat ka kontribuar praktikanti;
- Koncept dokumentet dhe dokumentet e politikave; raportet e përgatitura nga praktikanti ose me kontributin e tij/saj;
- Punime për analiza dhe kërkime; procesverbalet e hartuara nga praktikanti;
- Numri i takimeve të ndjekura dhe numri e lloji i aktiviteteve në të cilat ishte i përfshirë praktikanti.
- Secili praktikant individualisht do të përpilojë raport mbi përvojën e përgjithshme të ndjekjes së programit bazuar në në formularin përkatës.<sup>2</sup> Raporti i praktikantit do të duhet të përqendrohet në të kuptuarit e tij/ saj dhe përshtypjet mbi politikat dhe vendimmarrjen bazuar në përvojën e tij/saj praktike përmes programit;
- Në fund të programit, praktikantët do të përgatisin punim të përbashkët kërkimor, i cili do të paraqitet në konferencën përmbyllëse të programit.

### Treguesit e Performancës<sup>3</sup>

Praktikanti e respekton planin e punës 14-ditor në muaj; ai/ajo respekton orët e punës brenda kornizës kohore të dakorduar me mbikëqyrësin;

Praktikanti demonstroi interesim dhe përkushtim gjatë gjithë procesit të të mësuarit.

Deri në fund të programit, praktikanti është në gjendje të punojë në përputhje me dokumentet strategjike dhe planet e veprimit të institucioneve përkatëse;

Deri në fund të programit praktikanti ka të kuptuar të qartë të proceseve dhe mekanizmave të vendimmarrjes dhe politikëbërjes në institucionet përkatëse;

### Vendi:

Kandidatët e përzgjedhur do të vendosen në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në Prishtinë.

### Kohëzgjatja:

Programi i punës praktike do të zgjasë tre muaj (shtator-tetor-nëntor 2021).

Kandidatët e përzgjedhur duhet të paraqiten në vendet e caktuara të punës 14 ditë pune në muaj për katër orë në ditë<sup>4</sup>.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të jenë në dispozicion për dy ditë të plota të trajnimit përgatitor/fillestar para vedosjes në vendet e tyre të punës. Ata gjithashtu duhet të jenë në dispozicion për një sesion trajnimi një-ditor në mes të programit që mbahet në mes të tetorit 2021.

Pas përfundimit të programit, kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin pjesë në konferencë (dhjetor 2021), online ose me prani fizike (varësisht nga situata me COVID-19), ku ata do të ndajnë me publikun përvojën dhe përshtypjet e tyre rreth pjesëmarrjes në programin e punës praktike.

### Kualifikimet

- Të jetë mes moshës 20 dhe 24 vjeç në kohën e aplikimit në program;

<sup>2</sup>Përpilimi i raporteve individuale të praktikantëve, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet, do të prezantohet nga ekipi i Projektit të OSBE-së gjatë konferencës përmbyllëse të programit.

<sup>3</sup>Mbikëqyrësi/koordinatori i programit i secilit institucion bashkëpunues përgatit vlerësim të plotë për secilin praktikant bazuar në formularin përkatës.

<sup>4</sup>Kjo do të varet nga marrëveshjet pasuese me koordinatorët e programit në secilin prej institucioneve bashkëpunuese.

- Të jetë student i universitetit në kohën e aplikimit në program;
- Të jetë i regjistruar në fakultet në drejtimin përkatës (sociologji, çështje publike, shkenca politike, juridik, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhim dhe administrim biznesi, arkitekturë, teknologji informacioni etj.)
- Të demonstroj interesim të vërtetë për pjesëmarrje publike të rinjve në vendimmarrje;
- Inkurajohet të jetë i anëtarësuar në strukturat rinore (Këshill Lokal të Veprimit Rinor, Qendër Rinore) ose organizata të shoqërisë civile rinore; vullnetar; punëtor rinor etj.) (me paraqitje të dëshmisë së anëtarësimit);
- Të zotërojë njohuri themelore të mekanizmave të pjesëmarrjes publike në të gjitha nivelet;
- Të jetë entuziast, lojtar ekipi, i vetë-motivuar, i gatshëm për të mësuar;
- Të jetë i gatshëm për të avancuar aftësitë dhe njohuritë e tij/saj përmes ndjekjes së programit;
- Të jetë i hapur dhe tregoj interesim për vendosjen e synimeve, të përmbush pritjet dhe t'i përshtatet sfidave të programit;
- Të ketë zotërim shumë e mirë verbal dhe me shkrim të anglishtes; zotërim të shkëlqyeshëm verbal dhe me shkrim të shqipës, serbishtes ose të dy gjuhëve;
- Të ketë njohuri kompjuterike (pakoja e Microsoftit)

Shënim: Përparësi do t'iu jepet kandidatëve që u përkasin komuniteteve joshqiptare, të rinjve nga zonat rurale dhe kandidateve gra.

#### Shpërblimi i propozuar:

- *Shuma paushalle* prej 70 € për person/në muaj do t'iu jepet secilit kandidat të zgjedhur për mbulimin e kostos së transportit ditor dhe shpenzimeve të jetesës. Shuma do t'iu vihet në dispozicion secilit pjesëmarrës në para të gatshme në fund të çdo muaji pas dorëzimit të fletëve të nënshkruara të pjesëmarrjes.
- Nëse mbahet me prani fizike, ushqimi, pijet freskuese dhe mjetet e nevojshme gjatë trajnimit përgatitor, trajnimit në mes të programit dhe konferencës pas praktikës, do të sigurohen nga OSBE-ja.

Shënim: OSBE-ja nuk do të mbulojë asnjë shpenzim tjetër të shkaktuar nga praktikantët.

OSBE-ja nuk është në gjendje të mbulojë ndonjë shpenzim lidhur me sigurimin shëndetësor apo tjetër social.

#### Modaliteti i rekrutimit:

Kandidatët e interesuar kërkohen që të dërgojnë CV-në e tyre (maks. 1 faqe, që përmban të gjithë informacionin e kërkuar në pjesën e kualifikimeve) dhe një letër motivuese (maks. 1 faqe), në anglisht, në: [OMIKApprenticeship2021@osce.org](mailto:OMIKApprenticeship2021@osce.org), jo më vonë se më 30 qershor 2021.

Kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të ftohen për intervistë (personalisht - ose në online).

Procesi i përzgjedhjes do të kryhet nga paneli i përbërë nga anëtarë të institucioneve bashkëpunuese dhe ekipi i projektit të OSBE-së.